VENDIM
Nr.470, datë 16.4.2008

PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE, PYJE DHE KULLOTA, QË DO TË TRANSFEROHEN NË PRONËSI TË NJËSISË SË QEVERISJES VENDORE, KOMUNA BËRDICË, TË QARKUT TË SHKODRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, dhe të nenit 23 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, pyje dhe kullota, që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ të njësisë së qeverisjes vendore, komuna Bërdicë, të qarkut të Shkodrës, që do t'i transferohen në pronësi kësaj njësie.
2. Lista përfundimtare e pronave të paluajtshme, pyje dhe kullota, me 1 (një) fletë, që përfundon me numrin rendor 13 (trembëdhjetë), dhe lidhja 1 i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij. Bëjnë përjashtim sipërfaqet e trajtuara sipas vendimit nr.338, datë 6.6.2007 të Këshillit të Ministrave.
3. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Bërdicë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Njësia e qeverisjes vendore: komuna Bërdicë Lidhja nr. 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
3486-3498	Sipërfaqe me bimësi pyjore	Në pronësi